

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE "EH-CONSULTING" sh.p.k.**

KAPITULLI I

Dispozita te Pergjithshme

- Enea Halili lindur më 31/08/1990, lindur në Memaliaj, Tepelene madhor dhe me zotesi per te vepruar, identifikuar me Leternjoftim me nr. J00831070H , leshuar nga Ministria e Brendshme.

Ortaku me lart eshte madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili mbeshtetur ne ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare" I ndryshuar, dhe ne legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, vendosi sot me date 20/01/2024, si me poshte vijon:

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Të themeloje shoqerine me pergjegjesi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të ciles rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet "**EH-CONSULTING**" sh.p.k.

Neni 3

Shoqeria do te kete Seline e saj në Tirane, Rruga Ymer Kurti Ap 48, kati 11, Sheshi Willson;
Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Afati mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakëve.

Neni 5

Aktiviteti i shoqerise

Shoqeria "**EH-CONSULTING**" sh.p.k. do te kete si objekt:

- 1-Studime, projektme, trajnime, konsulencë per: Projekte urbanistike, projekte arkitektonike, projekte konstruktive, projekte instalator, projekte per vepra hidraulike, projekte rrugeshe – hekurudha, projekte urash dhe vepra arti, projekte gjeodet, studim gjeologo-inxhinierik–hidrogeologjik, projekte te impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projekte të sinjalizimit rrugor, studime të sizmologjisë inxhinierike studime e projektme të ndërtimit dhe mbylljes së vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta (urbane), studime e projektme të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza.
- 2- Sherbim ekspertize ne vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor.
- 3- Sherbim ekspertize ne mbrojtjen kunder zjarrit dhe shpetimin.
- 4-Sherbime ekspertize dhe profesionale lidhur me burimet energjetike. Sherbim ekspertize ne vleresim te pasurive te paluajtshme.
- 5-Auditimi i eficenses energjetike ne ndertesa dhe industrise.
- 6- Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore baze (sherbime te ekspertizes dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ ose kullota).
- 7-Vleresimi i objekteve industriale te cdo lloji. Hartimi i planeve te evakuimit.
- 8-Mbikqyrja (supervizimi) dhe kolaudimi i punimeve te zbatimit per te gjitha kategorite e punimeve.
- 9-Furnizim vendosje e linjave elektrike të TN, TM, TU mbi tokësore (ajrore) dhe nëntokësore (kabllore) për energji elektrike dhe telekomunikacioni, nënstacionet elektrike TN/TM dhe të tensionit të mesëm TM/TU (kabina elektrike).

- 10-Furnizim vendosje e makineri pajisje per centralet energjistik te cdo lloji, rrjete inxhinierike, objekte civile dhe industriale.
- 11- Realizimin e impianteve të telekomunikacionit.
- 12-Mirëmbajtje, remont profilaktik të mesëm e capital të transformatorëve elektrik të çdo lloji, makinave elektrike si dhe pajisjeve elektrike.
- 13-Import-eksport të materialeve elektrike, telekomunikacionit, sistemeve të alarmit, sistemeve kundra zjarrit, mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, tregtimin e mallrave të gatshëm si dhe cdo malli tjetër qe parashikon ligji.
- 14- Import-eksport të materialeve hidraulike, pompa, hidrosanitare, sistemeve kundra zjarrit, mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, tregtimin e mallrave të gatshëm si dhe cdo malli tjetër qe parashikon ligji.
- 14-Testimi dhe certifikimi i pajisjeve te ndryshme.
- 15-Ofrimi i cdo lloji konsulence dhe sherbimi inxhinierik per te gjitha fushat e percaktuara ne kete objekt dhe ato qe parashikon ligji. Prodhimi i energjise elektrike nga hidrocentralet dhe burimet e tjera te rinovueshme.
- 16-Hartimi i Planit te biznesit (analizes ekonomike) per cdo lloj veprimtarie. Menaxhimi i kontratave te ndryshme.

Neni 6

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne ortakët e saj. Ortaku themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise është në 10,000 (dhjete mije) LEK qe i takon ortakut themelues si me poshte:

1. Ortaku **z. Enea Halili**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 (dhjete mije) LEK, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7

Organi Vendimmarres

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Administratori

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates. Administrastoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 8

Administrimi

- 1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë per nje afat 5 vjecar nga data e regjistrimit te kesaj shoqerie prane QKB-se dhe do te veprojne me tagra te pakufizuara.

- Enea Halili, i cili ne te njejtën kohë ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e shoqerise ne menyre te pavarur.

Specimenti i firmes se administratorit:



NENI 9

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës:

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 10

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 11

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqipërisë.

NENI 12

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te lindre midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar. Ky akt themelimi eshte i pergatitur ne 2 (dy) kopje te barazvlefshme ne gjuhen shqipe me nga 5 faqe secila.

ORTAKU I SHOQERISE

Enea HALILI

